

Termt e Referencës

AktivizON.al – Qasje Inovative për rritjen e Pjesëmarrjes Aktive Rinore

Pozicioni: Ekspert i jashtëm për zhvillim Moduli trajnimi

Tipi i kontratës: Kontratë shërbimi

Kohëzgjatja: Korrik-Shtator 2022

Afati i aplikimit: 20.07.2022

Përtej Barrierave është një organizatë jofitimprurëse e shoqërisë civile, e themeluar në vitin 2004. Ne punojmë me të rinjtë në nivel kombëtar, rajonal dhe evropian, duke promovuar përfshirjen dhe ngritjen e kapaciteteve përmes edukimit joformal. Përtej Barrierave është Pika e Kontaktit e programeve Erasmus + YiA dhe European Solidarity Corps të Komisionit Evropian, për Shqipërinë.

MBI PROJEKTIN

AktivizON është një projekt strategjik që do të zhvillohet në kuadër të TEYC dhe implementohet nga organizata Përtej Barrierave për përmirësimin e punës rinore në Shqipëri përmes përdorimit të mjeteve dixhitale.

Projekti AktivizON ka për qëllim të zhvillojë kapacitetet e punonjësve/liderave/aktivistëve rinor të cilët punojnë direkt në fushën e diversitetit kulturor, pjesëmarrjes rinore, përfshirjes sociale, programeve rinore European dhe ofron mënyra krijuese të të mësuarit virtual, përmes internetit.

Përmes projektit AktivizON do të krijohet një platformë virtuale, e cila do të përmbajë 5 module trajnimi me tematike specifike sipas modelit të Kompetencave të përdorur në nivel Evropian.

Platforma do të ndërtohet në gjuhën Shqipe në mënyre që të jetë e lehtë dhe e kuptueshme për tu përdorur me funksionet dhe modalitet miqësore për të gjithë ata që kanë njohuri bazë të lundrimit në internet. Platforma do të jetë e aksesueshme për pesë vitet e ardhshme dhe do të përmirësohet sipas zhvillimeve të sektorit rinor në vazhdimësi.



Kjo platformë virtuale e cila vjen me qasjen e të mësuarit asinkron do të ofrojë akses për të mësuar duke përdorur mësimin online pa nevojën për tu takuar ballë për ballë me një trajner/fasilitues për këdo dhe nga cilido vend i Shqipërisë mjafton të kesh akses në internet.

Po ashtu ajo krijon qëndrueshmëri duke pasur hapësirën për ta mbushur me kurse të tjera shtesë gjatë viteve, të cilat do t'i përgjigjen nevojës dhe trendeve të punës me te rinjtë ne vend.

1. QELLIMI I PERGJITHSHEM DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE

Qellimi i projektit është përmirësimi dhe zhvillimi i punës me të rinjtë në Shqipëri, përmes fuqizimit (kualifikimit dhe trajnimit) të punonjësve rinorë, duke sjellë një qasje të re të të nxënit përmes metodave bashkëkohore të mesimit në rrjet (online).

1. Të ofrojë për herë të parë në Shqipëri një modalitet vetë-mësimi të moduleve bazë dhe me të rëndësishme të punës rinore.
2. Të rrisë kapacitetet e 150 punonjësve/lidera/aktivistë rinor në tematika të ndryshme të punës rinore sipas modelit të kompetencave të prezantuar nga Salto dhe strukturat përkatëse të Komisionit Europian.
3. Të promovojë vlerat e punës rinore me standarde cilësore, ndërgjegjësimin për rolin e punonjësve rinorë, ngritjen e urave të bashkëpunimit brenda sektorit rinor dhe fushave ndërsektoriale. (Edukimi formal dhe joformal, autoritetet publike, sektori privat dhe shoqëria civile).

2. TARGET GRUPI

- 150 punonjës rinor/ aktivistë /udhëheqës rinor/mësues/punonjës bashkie në fushën rinore nga e gjithë Shqipëria

3. MBI NDERTIMIN E MODULEVE TE TRAJNIMIT

Qëllimi specifik i kësaj thirrje është ndërtimi i pesë moduleve specifikë trajnimi nga 5 ekspertë të ndryshëm, të cilat do të krijohen dhe ndjekin modelin e Kompetencave Europiane dhe teorisë edukuese gjithëpërfshirëse të edukimit jo-formal dhe edukimit të vetë-drejtuar.



Të pestë modulet specifike synojnë të ngrejnë kapacitetet e të trajnuarve duke përmirësuar njohuritë, qëndrimet, aftësitë dhe sjellen mbi fushat specifike të moduleve.

3.1 Fushat e moduleve të trajnimit

Sipas kësaj thirrjeje, Përtej Barrierave po kërkon 5 ekspertë me eksperiencë në fushën rinore për krijimin e moduleve të trajnimit në një nga këto fusha:

a) Ekspert Modul 1 – Të drejtat sociale

b) Ekspert Moduli 2 – Edukimi për të drejtat e njeriut dhe puna rinore

c) Ekspert Moduli 3 – Qasje edukative dhe mjetet e punës në edukimin jo-formal

d) Ekspert Moduli 4 – Mësimi ndërkulturor në punën me të rinjtë

e) Ekspert Moduli 5 – Korpusi European i vullnetarëve- Cikli i menaxhimit të vullnetarëve European

3.2 FUSHEVEPRIMI I PUNES

Eksperti do të komunikojë nga afër dhe do të punojë nën mbikëqyrjen e organizatës koordinuese dhe koordinatorit të projektit.

Gjatë procesit të përgatitjes, eksperti do të kryejë si më poshtë:

- Hartimin dhe zhvillimin e një prototipi funksional të moduleve të mësimit online duke ndjekur një rrjedhë logjike
- Përgatitje të moduleve të trajnimit duke respektuar profilin e formatit të dhënë;
- Përfundimi i zhvillimit të moduleve të të mësuarit me ritëm të pavarur dhe ndërveprues;
- Të jetë plotësisht përgjegjës për cilësinë e modulit;
- Të sigurojë dërgimin në kohë të modulit të organizata koordinuese;

4. PROFILI I EKSPERTIT

Kompetencat:

- Ndjenjë e lartë përgjegjësie, interes për subjektet e projektit dhe të jetë i përkushtuar;
- Niveli i lartë i aftësive analitike;
- Menaxhues shumë i mire i kohës;
- Rrjedhshmëri në gjuhën shqipe (të shkruar, të folur);



- Aftësi të avancuara kompjuterike (MS Office - Word, Excel, Power Point, Internet) si dhe aftësi në përdorimin e mjeteve të tjera dixhitale (mentimeter, Kahoot etj);
- Një diplomë akademike në një fushë përkatëse (p.sh. shkenca sociale etj) ose përvojë praktike të vërtetuar ekuivalente;
- Së paku 2 vite përvojë pune në projekte lidhur me fushën e punës rinore; (Cdo projekt/aktivitet i lidhur me fushën e punës rinore i jep prioritet aplikantit)

5. PROCEDURA E APLIKIMIT

Aplikantët e interesuar duhet të dërgojnë dokumentet e kërkuara si më poshtë:

- Curriculum Vitae (shqip ose anglisht)
- Letër interesi

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimit është 20 Korrik 2022, 23:59 (dorëzimi i vonuar nuk do të pranohet), ne adresën e emailit: silvia.dervishi@beyondbarriers.org

6. PROCEDURA E VLERËSIMIT

Kriteret kryesore të përzgjedhjes do të jenë ekperiencia në punën me të rinjtë dhe njohja me tematikën.